



VENDIM

Nr. 10, Datë 03.07.2012

PËR SHOQYRTIMIN E ANKIMIT TË PARAQITUR NGA ZNJ. NATASHA CEPANI NË LIDHJE ME KONKURSIONIN PËR POZICIONIN E KANCELARIT NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Këshilli i Administrimit i Universitetit të Arteve në mbledhjen e tij të datës 03.07.2012, pasi shqyrtoi ankimin e paraqitur nga znj. Cepani si dhe dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve të anëtarëve,

VËREN

Znj. Natasha Cepani, konkurrenente për pozicionin e Kancelarit në UART ka paraqitur ankimim me nr. 924 prot., datë 29.06.2012. KAdm shqyrton këtë ankesë në bazë të pikës 2, germa dh të VKM nr. 875, datë 18.06.2008.

Në datën 25.06.2012 Këshilli i Administrimit ka zhvilluar fazën vlerësuese të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët pjesëmarrës në konkursin për pozicionin e punës "Kancelar i Universitetit të Arteve". Sipas procedurës së parashikuar për zhvillimin e konkursit, miratuar me Vendimin nr. 8, datë 25.06.2012, anëtarët e KAdm të Universitetit të Arteve kanë plotësuar formularët e vlerësimit, për secilin kandidat të paraqitur, duke vlerësuar kriteret me pikët përkatëse.

Siç rezulton edhe nga formularët e vlerësimit të kandidatës të përgatitura nga anëtarët e KAdm, kandidatja ka marrë 40 pikë në vlerësimin e kriterëve sipas dosjes së paraqitur dhe pikët maksimale në vlerësimin me gojë (30 pikë), duke grumbulluar 70 pikë gjithsej.

Nga vlerësimi i bërë për kandidatët e paraqitur ka rezultuar klasifikimi i mëposhtëm:

Nr.	Konkurrenti	Pikët e fituara
1.	Alma Sinanaj	100
2.	Natasha Cepani	70
3.	Xhensila Pine	36
4.	Eniela Agolli	27



Sipas pikës 2, germa d të VKM nr. 875, datë 18.06.2008, Këshilli i Administrimit ka përzgjedhur me votim të fshehtë, znj. Alma Sinanaj, e cila ishte një nga tre kandidaturat që kanë grumbulluar më shumë pikë.

Ankimimi i paraqitur nga znj. Natasha Cepani lidhet me sasinë e pikëve të grumbulluara nga dosja e paraqitur, duke pretenduar se vlerësimi nuk ishte i drejtë.

KAdm konsideron se formularët e vlerësimit janë plotësuar në mënyrë të rregullt nga secili anëtar dhe se pasqyron me vërtetësi gjendjen e dokumentacionit të paraqitur nga konkurrentja. Megjithatë KAdm vlerëson se ankimimet e paraqitura lidhur me konkurrimin për Kancelar i një IAL-je, duhet ti referohen vetëm procedurës së vendimmarrjes. Nga analiza e paraqitur më sipër KAdm vlerëson se procedura e ndjekur është në përputhje me VKM nr. 875, datë 18.06.2008 dhe aktet përkatëse të Këshillit të Administrimit.

Megjithatë KAdm konsideron të nevojshme të ritheksojë se klasifikimi me pikë, pavarësisht se përfaqëson një renditje të kandidatëve, nuk është kushti përfundimtar për shpalljen e fituesit, pasi fituesi përzgjidhet nga tre kandidatët e renditur me pikë më shumë, madje nëpërmjet një votimi të fshehtë në KAdm.

Për sa më sipër KAdm gjykon se ankimimi i paraqitur nga Znj. Cepani nuk është në përputhje me VKM nr. 875, datë 18.06.2008 dhe si i tillë ai nuk duhet të pranohet. Për këto arsye, Këshilli i Administrimit

VENDOSI

1. Mospranimin e ankimit nr. 924 prot., datë 29.06.2012 të paraqitur nga znj. Natasha Cepani.
2. Kopje e këtij Vendimi i njoftohet ankueses.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE